




Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 1/119
Datë: 07.04.2010

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, dhe të nenit 4 paragrafi (3) të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 7 prill 2010, mori

V E N D I M

1. Miratohen ekstraktet e procesverbaleve dhe transkriptet nga mbledhjet; 116, 117 dhe 118 të Qeverisë.
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.


Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 2/119

Datë: 07.04.2010

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 76 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-40, Rregullores Nr. 2001/19, për Degën e Ekzekutivit, si dhe të nenit 4 paragrafi (3) të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës Nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 7 prill 2010, mori

V E N D I M

Qeveria e Republikës së Kosovës, në pajtim me dokumentin "Mbikëqyrja e komunave në zbatimin e legjislacionit për vetëqeverisje lokale", të hartuar nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, me qëllim të përmirësimit të mbikëqyrjes së zbatimit të ligjit në komuna, ndërmerr hapat në vijim:

Mbikëqyrja e ligjshmërisë së akteve të komunave për kompetenca vetanake

1. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal është përgjegjëse për mbikëqyrjen e ligjshmërisë së akteve të komunave, nëse përgjegjësia për mbikëqyrje nuk i jepet me ligj të veçantë ndonjë ministrie përgjegjëse apo ndonjë institucioni që ka të bëjë me lëmi të posaçme;
2. Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, Ministria e Ekonomisë dhe Financave dhe Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal formojnë komisionin e përbashkët për mbikëqyrjen e ligjshmërisë së akteve të komunave në ushtrimin e kompetencës vetanake, lidhur me "zhvillimin ekonomik lokal dhe qëndrueshmërinë ekonomike lokale";
3. Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, themelojnë komisionin e përbashkët për mbikëqyrjen e ligjshmërisë së akteve të komunave në ushtrimin e kompetencës vetanake, lidhur me "planifikimin urban dhe rural";
4. Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural dhe Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, themelojnë komisionin e përbashkët për mbikëqyrjen e

ligjshmërisë së akteve të komunave në ushtrimin e kompetencës vetanake, lidhur me "shfrytëzimin e tokës dhe zhvillimin";

5. Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, themelojnë komisionin e përbashkët për mbikëqyrjen e ligjshmërisë së akteve të komunave në ushtrimin e kompetencës vetanake, lidhur me "zbatimin e rregulloreve të ndërtimit dhe standardeve për kontrollin e ndërtimit";
6. Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, themelojnë komisionin e përbashkët për mbikëqyrjen e ligjshmërisë së akteve të komunave në ushtrimin e kompetencës vetanake, lidhur me "mbrojtjen e mjedisit lokal";
7. Ministria e Ekonomisë dhe Financave, Ministria e Transportit dhe Telekomunikacionit, Ministria e Energjisë dhe Minierave dhe Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, themelojnë komisionin e përbashkët për mbikëqyrjen e ligjshmërisë së akteve të komunave në ushtrimin e kompetencës vetanake, lidhur me "ofrimin dhe mirëmbajtjen e shërbimeve publike dhe shërbimeve komunale, përfshirë furnizimin me ujë, kanalizimin dhe drenazhin, trajtimin e ujërave të zeza, menaxhimin e mbeturinave rrugëve lokale, transportit lokal dhe skemave të ngrohjes lokale";
8. Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, themelojnë komisionin e përbashkët për mbikëqyrjen e ligjshmërisë së akteve të komunave në ushtrimin e kompetencës vetanake, lidhur me "përgjigje ndaj rasteve emergjente lokale;
9. Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, themelojnë komisionin e përbashkët për mbikëqyrjen e ligjshmërisë së akteve të komunave në ushtrimin e kompetencës vetanake, lidhur me "ofrimin e arsimit publik parashkollor, fillor dhe të mesëm, duke përfshirë regjistrimin dhe licencimin e institucioneve edukative, punësim, pagesën e rrogave dhe trajnimin e instruktorëve dhe administratorëve të arsimit";
10. Zyra e Kryeministrit/Zyra Këshillëdhënëse për të Drejtat e Njeriut, Agjencioni për Barazi Gjinore në Kosovë dhe Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, themelojnë komisionin e përbashkët për mbikëqyrjen e ligjshmërisë së akteve të komunave në ushtrimin e kompetencës vetanake, lidhur me "promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut;
11. Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, themelojnë komisionin e përbashkët për mbikëqyrjen e ligjshmërisë së akteve të komunave në ushtrimin e kompetencës vetanake, lidhur me "ofrimin e përkujdesit publik primar shëndetësor";
12. Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Ministria e Ekonomisë dhe Financave, Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, themelojnë komisionin e përbashkët për mbikëqyrjen e ligjshmërisë së akteve të komunave në ushtrimin e kompetencës vetanake, lidhur me "Ofrimin e shërbimeve familjare dhe shërbimeve të tjera të mirëqenies sociale, siç është përkujdesja për të

cenueshmit, strehimin familjar, përkujdesjen fëmijërore, përkujdesin për të moshuarit, duke përfshirë regjistrimin dhe licencimin e këtyre qendrave përkujdesëse, punësimin, pagesën e rrogave dhe trajnimin e profesionistëve të mirëqenies sociale;

13. Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Ministria e Ekonomisë dhe Financave, Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, formojnë komisionin e përbashkët për mbikëqyrjen e ligjshmërisë së akteve të komunave në ushtrimin e kompetencës vetanake, lidhur me "banimin publik";
14. Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, formojnë komisionin e përbashkët për mbikëqyrjen e ligjshmërisë së akteve të komunave në ushtrimin e kompetencës vetanake, lidhur me "shëndetësinë publike";
15. Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, Ministria për Kulturë, Rini dhe Sport, Ministria e Transportit dhe Telekomunikacionit, Ministria për Bujqësi dhe Zhvillimin Rural dhe Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, formojnë komisionin e përbashkët për mbikëqyrjen e ligjshmërisë së akteve të komunave në ushtrimin e kompetencës vetanake, lidhur me "licencimin e shërbimeve publike dhe objekteve, duke përfshirë ato që kanë të bëjnë me argëtimin, aktivitete kulturore dhe të lira, ushqimin, strehimin, tregjet, shitësit në rrugë, transportimin lokal publik dhe taksitë";
16. Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, formojnë komisionin e përbashkët për mbikëqyrjen e ligjshmërisë së akteve të komunave në ushtrimin e kompetencës vetanake, lidhur me "ofrimin dhe mirëmbajtjen e parqeve dhe hapësirës publike";
17. Ministria e Tregtisë dhe Industrisë dhe Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, formojnë komisionin e përbashkët për mbikëqyrjen e ligjshmërisë së akteve të komunave në ushtrimin e kompetencës vetanake, lidhur me "turizmin";
18. Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, formojnë komisionin e përbashkët për mbikëqyrjen e ligjshmërisë së akteve të komunave në ushtrimin e kompetencës vetanake, lidhur me "aktivitetet kulturore dhe të lira";

Mbikëqyrja e ligjshmërisë së akteve të komunave për kompetencat vetanake të zgjeruara

1. Ministria e Shëndetësisë është përgjegjëse për mbikëqyrjen e ligjshmërisë së akteve dhe aktiviteteve të komunave në ushtrimin e kompetencës vetanake të zgjeruara "përkujdesja dytësore shëndetësore";
2. Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë është përgjegjëse për mbikëqyrjen e ligjshmërisë së akteve dhe aktiviteteve të komunave në ushtrimin e kompetencës vetanake të zgjeruara "shkollimi universitar";


3. Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit është përgjegjëse për mbikëqyrjen e ligjshmërisë së akteve dhe aktiviteteve të komunave në ushtrimin e kompetencës vetanake të zgjeruara “fusha e kulturës”;
4. Ministria e Punëve të Brendshme është përgjegjëse për mbikëqyrjen e ligjshmërisë së akteve dhe aktiviteteve të komunave në ushtrimin e kompetencës vetanake të zgjeruara “zgjedhja e komandantëve të stacioneve policore”;

Mbikëqyrja e ligjshmërisë së akteve të komunave për kompetencat e deleguara

1. Ministria e Administratës Publike dhe Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, formojnë komisionin e përbashkët për mbikëqyrjen e ligjshmërisë së akteve të komunave në ushtrimin e kompetencës të deleguara, lidhur me “shënimet kadastrale”;
2. Ministria e Punëve të Brendshme, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, Ministria e Administratës Publike dhe Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, formojnë komisionin e përbashkët për mbikëqyrjen e ligjshmërisë së akteve të komunave në ushtrimin e kompetencës të deleguara, lidhur me “regjistrimin e votuesve”;
3. Ministria e Punëve të Brendshme dhe Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, formojnë komisionin e përbashkët për mbikëqyrjen e ligjshmërisë së akteve të komunave në ushtrimin e kompetencës të deleguara, lidhur me “regjistrimin civil”;
4. Ministria e Tregtisë dhe Industrisë dhe Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, formojnë komisionin e përbashkët për mbikëqyrjen e ligjshmërisë së akteve të komunave në ushtrimin e kompetencës të deleguara, lidhur me “regjistrimin e bizneseve dhe licencimin”;
5. Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Ministria e Ekonomisë dhe Financave dhe Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, formojnë komisionin e përbashkët për mbikëqyrjen e ligjshmërisë së akteve të komunave në ushtrimin e kompetencës të deleguara, lidhur me “distribucionin e pagesave të ndihmës sociale (me përjashtim të pensioneve)”;
6. Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural dhe Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, formojnë komisionin e përbashkët për mbikëqyrjen e ligjshmërisë së akteve të komunave në ushtrimin e kompetencës të deleguara, lidhur me “mbrojtjen e pyjeve që ndodhen në territorin e komunës në kuadër të autorizimeve të deleguara nga autoriteti qendror, duke përfshirë edhe dhënien e licencave për prerjen e drurëve në bazë të rregullave të miratuara nga Qeveria.
7. Ministrat e ministrive përkatëse që kanë të bëjnë me këtë vendim, ndërmarrin të gjitha masat për zbatimin e këtij vendimi, përfshirë formimin e komisioneve, brenda 15 ditëve, pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi.
8. Kryesues të komisioneve për mbikëqyrjen e ligjshmërisë së akteve të organeve të komunave, janë ministritë e para të përcaktuara në secilën pikë të këtij vendimi;

9. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal është përgjegjëse për koordinimin dhe raportimin për çdo tre muaj, lidhur me mbikëqyrjen e ligjshmërisë së akteve të nxjerra nga organet e komunave, përkatësisht Kuvendi i Komunës dhe Kryetari i Komunës.

10. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.


Hashim THAÇI
Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- të gjitha komunave
- Komisionit Qendror të Zgjedhjeve
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government


Nr. 3/119

Datë: 07.04.2010

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, dhe të nenit 4 paragrafi (3) të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 7 prill 2010, mori

V E N D I M

1. Miratohet raporti i punës së Grupit Ndërministror për Decentralizim.
2. Mandati i Grupit Ndërministror për Decentralizim zgjatet deri më 4 prill 2012.
3. Miratohet, me ndryshimet e rekomanduara, Plani i Veprimit për Zbatimin e Decentralizimit.
4. Ngarkohet Ministria për Administrimin e Pushtetit Lokal dhe ministritë anëtare të Grupit Ndërministror për Decentralizim për zbatimin e këtij vendimi.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.


Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 4/119
Datë: 07.04.2010

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, dhe të nenit 4 paragrafi (3) të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 7 prill 2010, mori

V E N D I M

1. Miratohet Projektligji për Efiçencën e Energjisë.
2. Obligohet Sekretari i përhershëm i Zyrës së Kryeministrit që projektligjin nga pika 1. e këtij vendimi t'ia procedojë për shqyrtim dhe miratim Kuvendit të Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THACI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 5/119

Datë: 07.04.2010

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, dhe të nenit 4 paragrafi (3) të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 7 prill 2010, mori

V E N D I M

1. Ndahen mjete financiare në shumë prej 15.000 (pesëmbëdhjetëmijë) euro për mbulimin e shpenzimeve për festën memoriale të komunitetit turk në Kosovë.
2. Mjetet nga pika 1. e këtij vendimi ndahen nga rezervat e Qeverisë, shpenzime të paparashikuara, dhe derdhen në xhirollogarinë numër 20 - 12 - 0000131438 - 78 në Bankën Komerciale TEB.
3. Ngarkohet Ministria për Ekonomi dhe Financa për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government


Nr. 6/119

Datë: 07.04.2010

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, dhe të nenit 4 paragrafi (3) të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 7 prill 2010, mori

V E N D I M

1. Ndahen mjete financiare në shumë prej 18.187,00 (tetëmbëdhjetëmijënjëqindetëdhjeteshtatë) euro për mbulimin e shpenzimeve për ceremoninë e varrimit të ish kryetarit të komunës së Istogut z. Fadil Ferati.
2. Mjetet nga pika 1. e këtij vendimi ndahen nga rezervat e Qeverisë, shpenzime të paparashikuara, dhe barten në xhironlogarinë e znj. Drita Ferati, numër 1303271100408810 në Bankën për Biznes.
3. Ngarkohet Ministria për Ekonomi dhe Financave për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.


Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë